



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

2009
Nr. ___ Prot

Vlorë më 29.09.2025

VENDIM

Nr. 15 datë 25.09.2025

**“PËR MIRATIMIN E PJESMARRJES SË KËSHILLIT TË QARKUT VLORE NË
PROJEKTIN CRSD@SME PJESË E PROGRAMIT INTERREG EUROPE”**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligj Nr. 65/2022 datë 15.9.2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes Financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të Asistencës Financiare të Be-së për Republikën e Shqipërisë në Kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA), Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 20.9.2023 për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III) pikës f të nenit 11 të Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë, Nr.13, datë 09.07.2024 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren “Për funksionimin e Administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë”, miratuar me VKQ Nr. 12, datë 22.06.2020, Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë, Nr.7, datë 26.03.2024 “Për autorizimin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë të nënshkruajë formatet e aplikimit, marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe çdo dokument tjetër për aplikimet në thirrjet e hapura të projekteve me partnerë të huaj”, Marrëveshjes së Partneritetit për projektin “CRSD@SME” “Forcimi i konkurrueshmërisë së NVM-ve përmes raportimit të besueshëm mbi qëndrueshmërinë” protokolluar me tonën me Nr.1220 Prot datë 17.06.2025.

VENDOS:

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Këshillit të Qarkut Vlorë në projektin CRSD@SME “Forcimi i konkurrueshmërisë së NVM-ve përmes raportimit të besueshëm mbi qëndrueshmërinë” (Increased competitiveness of SMEs through valid sustainability reporting) në partneritet me PXL University of Applied Sciences and Arts Belgjikë si Partner Lider dhe me një buxhet total të projektit prej **1,478,646.00 €**.
2. Vlera e buxhetit për Këshillin e Qarkut Vlorë është **202,372.00 €**. Vlera e bashkëfinancimit në zbatimin e projektit, si kontribut i institucionit është në masën 20% vlerë që ngarkon buxhetin e Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e gjithë administrata e Këshillit të Qarkut Vlorë.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +35533421608



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas pikës 3, neni 78 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015
“Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI

Ervis MOÇKA

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2025

Adresa: Këshilli I Qarkut Vlorë
Pallati I Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +35533421608



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË



RELACION

CRSD@SME “Forcimi i konkurrueshmërisë së NVM-ve përmes raportimit të besueshëm mbi qëndrueshmërinë” (Increased competitiveness of SMEs through valid sustainability reporting)

Projekti CRSD – Circular Rural and Sustainable Development, i financuar nga Programi Interreg Europë, me partner Lider PXL University of Applied Sciences and Arts Hasselt, **Belgjikë**, dhe partnerë Këshillin e Qarkut Vlorë **Shqipëri**, JAIP - South Bohemian Agency for Support to Innovation **Çeki**, University of Applied Sciences Brandenburg Gjermani, Business Support Centre, Ltd, Kranj **Slloveni**, Rajoni i Peleponezit **Greqi** ka për qëllim të adresojë sfidat kryesore të zhvillimit rural përmes promovimit të ekonomisë qarkulluese, forcimit të kapaciteteve institucionale të autoriteteve vendore, ruajtjes së mjedisit dhe biodiversitetit, si dhe nxitjes së bashkëpunimit ndër-rajonal dhe ndërkombëtar me një buxhet në total prej **1,478,646.00€**.

Vlera e buxhetit për Këshillin e Qarkut Vlorë është **202,372.00 €**. Një element i rëndësishëm i projektit është shkëmbimi i eksperiencës ndërmjet partnerëve dhe zbatimi i një projekti pilot ndërmjet Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Universitetit e Shkencave të Aplikuara në Brandenburg Gjermani i cili do të shërbejë si praktikë konkrete për përmirësimin e politikave dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm në zonat rurale.

Roli i Këshillit të Qarkut Vlorë

Këshilli i Qarkut Vlorë, si partner në këtë projekt, ka një rol të rëndësishëm dhe përfaqësues, i cili konsiston në:

- Koordinimin institucional në nivel qarku me bashkitë dhe institucionet përgjegjëse për zhvillimin rural dhe mjedisin;
- Organizimin e takimeve me aktorët lokalë për identifikimin e nevojave dhe potencialeve zhvillimore;
- Zhvillimin dhe zbatimin e një projekti pilot që lidhet me praktikën e ekonomisë qarkulluese dhe të qëndrueshme në të gjithë territorin e Qarkut;
- Shkëmbimin e përvojave përmes pjesëmarrjes aktive në takime ndërkombëtare, vizita studimore dhe aktivitete të platformës së të mësuarit të politikave (Policy Learning Platform);
- Kontributin në hartimin e dokumenteve strategjike dhe rekomandimeve politike për zhvillimin rural të qëndrueshëm në nivel vendor dhe rajonal.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Përfshirja e Këshillit të Qarkut Vlorë në projektin CRSD përbën një mundësi strategjike për të rritur kapacitetet institucionale, për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovativ të zonave rurale të qarkut, si dhe për të forcuar rolin e institucionit tonë në proceset e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Ilda Lamaj

Specialist për Arsimit, Kulturën, Turizmin, Çështjet Sociale dhe Zhvillimin e Projekteve

Palush Naci

Specialist për Shërbimet, Transportin dhe Emergjencat Civile

Mauricio Pashaj

Specialist Finance për zbatimin e buxhetit